



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 19.5.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Elheme Hetemi, Berat Luzha, Selvie Halimi, Zef Morina, Dragiša Mirić.

Munguan : Zulf Merxha, Ali Lajçi, Myrvete Pantina, Heset Cakolli.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i agjendës së vizitave në terren,
3. Leximi i dytë i p/l për Bujqësi e Zhvillim Rural-konfirmimi

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i agjendës së vizitave në terren

Lulzim Zeneli njoftoi anëtarët e komisionit me shkresën e dërguar nga Enver Tahiri (MMPH) i cili ka sugjeruar 5 komuna për të vizituar rreth monitorimit të Ligjit për Mbeturina : Prishtina, Gjilani, Peja, Drenasi dhe Shtime, ndaj kërkoi që komisioni të harmonizoi qëndrimin rreth vizitave.

Naim Maloku tha se nuk e ka të qartë pse janë sugjerua Shtimja dhe Drenasi , pasi që ato janë të lidhura me Ferizajin përkatësisht Prishtinën. Ai propozoi Prizrenin, ngase atje ka pasur peticione nga qytetarët rreth ndërtimit të deponisë nga donacionet dhe ndërkombëtarët.

Elheme Hetemi propozoi Mitrovicën.

Zef Morina ishte i mendimit të mos anashkalohen komunat e sugjeruara nga MMPH, sidomos komunat e vogla, ndërkaq më tutje të shkohet nëse premtion koha edhe në komunat tjera, me çka u pajtua edhe **Berat Luzha**.

Komisioni u pajtua që Peja të zëvendësohet me **Prizrenin**.

Kjo pikë përfundoi si vijon :

P Ë R F U N D I M

- 1. Në fillim të qershorit do të vizitohen zyrtarët komunal dhe deponitë në qytetet si vijon : Prishtina, Gjilani, Prizreni, Shtimja dhe Drenasi, sipas skemës që do të përgatitet nga Blerim Vela dhe Koordinatori i Komisionit, e cila skemë do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës (pyetësi, komunat, lista e zyrtarëve për komunikim, datat etj).**
- 2. Komisioni vizitat duhet ti kryej mundësisht pa u nda në grupe.**

3. Leximi i dytë i p/l për Bujqësi e Zhvillim Rural-konfirmimi

Lulzim Zeneli konstatoi se projektligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është i gatshëm për leximin e dytë, ndaj me pajtimin e komisionit u sugjerua për leximin e dytë në seancën e radhës.

Të ndryshme

Elheme Hetemi kërkoi harmonizimin e qëndrimit të komisionit rreth kërkesës së Bahri Hysenit në seancën plenare dt.15.5.2009 për amendamentin 2 tek projektligji i Biocideve, mirëpo nuk kishte qëndrim, ngase kërkesa e tillë nuk është e bazuar dhe për atë do të jap shpjegimin kryetari i komisionit , nëse ka nevojë.

Naim Maloku kërkoi realizimin e detyrës së dhënë në mbledhjen e fundit për kryetarin e komisionit rreth projektligjit për rrezatimin jonizues, për çka kryetari **Lulzim Zeneli** tha se nuk është realizuar për shkak të vizitës që parashihet të bëhet nga nënkryetari Amerikan në Kosovë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,35, mbledhja e radhës do të mbahet më 26.5.2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli